



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE  
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA  
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT



## Tipologjitë e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Republikën e Kosovës



## PËRMBAJTJA

HYRJE.....	4
PASTRIMI I PARAVE NË SISTEMIN BANKAR.....	5
Kredit bankare të përdorura për justifikimin e prejardhjes së fondeve .....	5
Bartje e mjeteve në drejtim të vendeve të njohura për trafikim të lëndëve narkotike .....	7
Transfere ndërkombëtare të fondeve dhe falsifikim i parave .....	8
Deponim dhe bartje e mjeteve nën shoqërimin e personit të njëjtë .....	9
Përdorimi tepër i madh i transaksioneve në kesh-depozita krahasuar me aktivitetin e biznesit - Aktivitet intensiv në para të gatshme .....	10
TRAFIKIM ME QENIE NJERËZORE .....	12
Transfere të fondeve jashtë vendit të përfituara nga aktivitetet e paligjshme – trafikim me qenie njerëzore .....	12
PASURIT E PALUAJTSHME .....	15
Investimi i mjeteve në pasuri të patundshme .....	15
KOMPANITË E SIGURIMEVE .....	19
Lëvizje e mjeteve ndërmjet disa kompanive me të njëjtin pronar dhe integrim i atyre mjeteve përmes sigurimeve në të cilën kompani sigurimesh paraqitet i njëjti person.....	19
PASTRIMI I PARAVE, KONTRABANDA DHE EVAZIONI FISKAL.....	21
AGJENSIONET PËR TRANSFER PARASH DHE KËMBIMORET .....	22
FINANCIMI I TERRORIZMIT.....	23
LOJRAT E FATIT DHE KAZINOT.....	24
PASTRIMI I PARAVE I BAZUAR NË TREGTI.....	27





## HYRJE

Gjashtëmujori i parë i vitit 2013, ishte një periudhë e rëndësishme dhe e frytshme për Njësinë e Inteligjencës Financiare. Ky institucion ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për hetime të ndryshme penale duke ofruar raporte të inteligjencës për transaksione të dyshimta, përcjelljen e parasë së gatshme dhe në të njëjtën kohë duke siguruar informacione për rrezikun që ka vendi ynë nga veprat penale të Shpërlarjes së Parasë dhe Financimit të Terrorizmit.

Në bazë të ligjit 03/L-196 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin 04/L-178, Njësia për Inteligjencë Financiare për herë të parë përpilon këtë studim të tipologjive lidhur me veprat penale të Pastrimit të Parave (PP) dhe Financimit të Terrorizmit (FT). Qëllimi i publikimit të këtij studimi bëhet me qëllim të njoftimit të opinionit lidhur me punën e NJIF-K, duke pasqyruar rrezikun që paraqitet në raste të ndryshme dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit në raste konkrete.

Tipologjitë e paraqitura përmes këtij raporti, poashtu do të jenë në ndihmë të subjekteve raportuese për të kuptuar natyrën e PP /FT dhe kërcënimeve të tyre, ku në mes tjerash do të jenë në mbështetje të dizajnit të strategjive efektive për të trajtuar këto kërcënime.

Këto tipologji gjithashtu u ndihmojnë edhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit për të hetuar dhe ndjekur personat e përfshirë në PP dhe FT, si dhe hartimin dhe zbatimin e masave efektive parandaluese.

Gjithashtu brenda këtij raporti vjetor të Tipologjive përfshihen edhe indikatorët e PP dhe FT si dhe disa nga teknikat dhe metodat e analizimit. Shpresojmë që studimi dhe analizimi i rasteve të paraqitura në këtë raport do të jetë një mbështetje për subjektet raportuese duke përfshirë në veçanti institucionet financiare dhe jo-financiare, pastaj kazino, agjentët dhe ndërmjetësuesit e pasurive të patundshme, noterët dhe avokatët, kontabilistët dhe auditorët etj të cilët janë të përfshirë direkt në zbatimin e ndërmarrjes së masave parandaluese në veçanti kujdesin e duhur ndaj klientit, identifikimin e klientëve si dhe monitorimin special të transaksioneve të veçanta.

Ky raport përmban raste dhe situata ilustruese (të pastruara nga të dhënat konfidenciale), në lidhje me aktivitetin që bëhet në NJIF-K me qëllim të zbulimit dhe luftimit të dukurive negative të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Andaj, nëpërmes të këtij raporti janë paraqitur përpjekjet për zgjidhjen e një numër të caktuar të rasteve ilustruese nga vitet e kaluara.

**Dardan NUHIU**

**Drejtor, Njësia për Inteligjencë Financiare**

## **PASTRIMI I PARAVE NË SISTEMIN BANKAR**


### **Rasti 1**

#### **Kredit bankare të përdorura për justifikimin e prejardhjes së fondeve**

Personi S ishte pronar i dy kompanive “A” dhe “B” të cilat morën dy kredi mjaft të larta në një bankë në Kosovë në të njëjtën periudhë kohore. Vlera e atyre kredive bankare ishte 1,500,000 euro dhe 450,000 euro, ku qëllimi i marrjes së atyre kredive ishte “rritja e kapaciteteve të biznesit” dhe “blerja e mallrave”. Gjatë analizimit të rrjedhës së atyre kredive ishte vërejtur se ato shuma kishin një destinim krejtësisht ndryshe nga çfarë ishte kërkuar fillimisht. Që të dy ato shuma janë transferuar tek një kompani tjetër “C”, brenda një dite të vetme, me përshkrime tepër të dyshimta (huazim dhe transfer i mjeteve) dhe pa justifikim të qartë ekonomik apo biznesor. Pronar i Kompanisë “C” është Personi H, i cili njëherit është edhe bashkëpronar i njërit nga bizneset e familjes “S”, Kompania Investive “M”.

Fondet e pranuar nga Kompania “C” nuk qëndruan më shumë se një ditë në llogarit e saj bankare, pasi që vetëm një ditë më vonë, pjesa më e madhe e atyre dy shumave në vlerë prej 1.9 milion euro transferohet tek Kompania “B”. Qëllimi i bartjes së asaj shume aq të madhe ishte blerja e mallrave, por që në realitet shkëmbimi tregtar në mes kompanive “B” dhe “C” kurrë nuk kishte ndodhur. Për këtë më së miri tregon fakti se ato fonde kishin si destinacion llogarinë bankare personale të personit kryesor të dyshuar Personi S, dhe në fund bartjen e një pjese të atyre mjeteve tek një person tjetër i quajtur Personi K i cili pranoi nga personi S një shumë të konsiderueshme të mjeteve prej 1.6 milion euro, në emër të blerjes së aksioneve. Personi K ishte një investues në industrinë turistike në disa vende të ndryshme. Gjithashtu ky person nënshkroi një kontratë me personin G për faljen e aksioneve të kompanisë M. Ky i fundit ka njëherit edhe lidhje familjare me Personin S. Dyshohet se kontrata për faljen e aksioneve ishte bërë me qëllim të ndryshimeve në strukturën e aksionarëve, ndërsa transferimi i mjeteve nga Personi S tek Personi K dyshohet se është bërë për integrimin e mjeteve përkatësisht për investime jashtë vendit në turizëm.

## PASTRIMI I PARAVE NË SISTEMIN BANKAR



Grafikoni nr.1






Rasti 2

**Bartje e mjeteve në drejtim të vendeve të njohura për trafikim të lëndëve narkotike**

Një person me shtetësi kosovare ‘G’ transferonte fonde në disa nga vendet e Amerikës Latine të njohura ndërkombëtarisht për eksport të lëndëve narkotike. Po ashtu i njëjti persona në të njëjtën periudhë kohore barte dhe pranonte mjete monetare edhe nga disa vende tjera sidomos nga Shteti “Z”, si dhe nga një shtet tjetër i Bashkimit Evropian. Nga verifikimet e kryera rezultojë që ‘G’ ishte zënë disa herë nga autoritetet policore duke kryer vepra penale, ndër kryesoret ishin kontrabandë, posedim i substancave narkotike, kërcënim etj. Nga bashkëpunimi me institucionet tjera të zbatimit të ligjit ishte mësuar se personi në fjalë ushtronte profesionin e vozitësit dhe mbante linjën e rregullt për në disa vende të BE-së.

Duke analizuar transaksionet financiare të Personit ‘G’ është vërejtur se ai bënte lëvizje të shpeshta të fondeve me Personin ‘M’ ku ky i fundit shpesh herë pranon fonde nga disa persona nga dy vende fqinjë të Ballkanit. Ana kreditore e llogarive të Personit ‘G’ përbëhej kryesisht nga disa transfere hyrëse ndërkombëtare, fonde ato të dërguara nga disa persona të ndryshëm kryesisht nga Shteti “Z” dhe disa vende të Bashkimit Evropian. Ajo çka e bënte të dyshimtë këtë rast është fakti se një pjesë e atyre mjeteve monetare transferoheshin pastaj tek disa persona në Shtetin “X” dhe Shtetin “Y”.




Grafikoni nr.2

Rasti 3

Transfere ndërkombëtare të fondeve dhe falsifikim i parave

Një subjekt raportues kishte njoftuar se disa kompani dhe persona me shtetësi të huaj , depononin para në kesh dhe pastaj të njëjtat fonde i transferonin tek i njëjti përfitues në një shtet aziatik. Në bazë të shënimeve të grumbulluara është vërejtur se thuajse gjithë ata persona depononin mjete monetare nën ose shumë afër pragut të raportimit. Për rreth 5 vite, personat e njëjtë kishin arritur t'i transferonin në shtetin e origjinës së tyre mbi 6 milion Euro. Thuajse çdo herë personat në fjalë kryenin deponime në para të gatshme shumë afër pragut të raportimit, dhe kjo rrit dyshimin se personat e tillë kanë provuar disa herë t'i shmangen formës së raportimit për origjinën dhe prejardhjen e fondeve. Përshkrimi i transfereve jashtë vendit kryesisht ishte “pagesë për mall”. Gjatë verifikimit të dokumenteve është vërejtur se njëri nga shtetasit e huaj ka deklaruar se profesioni i tij të cilin e ushtron në Kosovë është floktar (berber) por që në realitet kompania e themeluar nga ai person, si aktivitet kryesor të saj kishte shitblerjen e tekstilit, dhe përveç kësaj edhe pagesat ndërkombëtare bëheshin për qëllime të tekstilit.

Gjatë analizave financiare të kryera nga NJIF-K dhe duke shikuar të kaluarën kriminale të personave në fjalë është vërejtur se 4 nga 16 personat ishin arrestuar për falsifikim të parave brenda një intervali shumë të shkurtër kohorë (rreth 3 ditë), përderisa dy tjerë nuk kishin leje qëndrimi në Kosovë. Po ashtu duke shikuar një diferencë tepër të madhe në vlerë prej rreth 5.5 milion Euro ndërmjet transfereve ndërkombëtare dhe importeve të deklaruara nga kompanitë e personave të dyshuar, rritet dyshimi se këta persona mund edhe të jenë të përfshirë në kontrabandë ose evazion fiskal, si vepra të ndërlidhura të pastrimit të parave.



Grafikoni nr.3




Rasti 4

Deponim dhe bartje e mjeteve nën shoqërimin e personit të njëjtë

Një raport i aktivitetit të dyshimtë kishte zbuluar se një person shtetas i Kosovës (Personi A) kryente disa transfere ndërkombëtare të njëpasnjëshme brenda një periudhe mjaft të shkurtër kohore nga mesi i muajit Prill 2011 deri më 19 Maj 2011. Dyshimi bazohet në atë se Personi A kishte kryer disa deponime në kesh në vlera të mëdha dhe pas secilit deponim ai i transferonte ato mjete jashtë vendit gjithmonë i shoqëruar nga një person tjetër i cili bazuar në pamjen e jashtme të tij dukej se ishte shtetas i huaj (Personi B), dhe si arsyetim për prejardhjen e mjeteve ai deklaronte se i ka nga një anëtar i ngushtë i familjes së tij i cili jetonte në një vend të Bashkimit Evropian, por në fakt subjekti raportues kishte vërejtur se transferet ndërkombëtare kryesisht shkonin në drejtim të një vendi nga Lindja i cili ishte i njohur për eksport të madh të mallrave për në vendin tonë dhe në të shumtën e rasteve ato mjete transferoheshin për blerjen e kompjuterëve, pastaj pagesa për pjesë të veturave, bizhuteri etj.

NJIF-K përmes verifikimit të kryer dhe grumbullimit të informacionit nga autoritetet tatimore, bankat komerciale dhe agjensionet tjera të zbatimit të ligjit rezultojë që personi në fjalë nuk kishte më parë në dispozicion një shumë aq të madhe të parave në dorë, dhe përveç kësaj i njëjti person asnjëherë nuk kishte kryer ndonjë aktivitet biznesor legal dhe të cilat mund t'i siguronin të ardhura nga biznesi dhe gjithashtu nuk rezultonte të kishte kryer ndonjëherë ndonjë import ose eksport të mallrave e të cilat mund të justifikonin transferin e fondeve jashtë vendit. Prandaj hipoteza e NJIF-K shkoi në atë drejtim që Personi A kryente transaksione bankare dhe i shërbente Personit B, ku ky i fundit mund ta ketë përdorur atë person për qëllime të evazionit fiskal ose kontrabandës së mallrave.




Grafikoni nr.4

## Përdorimi tepër i madh i transaksioneve në kesh-depozita krahasuar me aktivitetin e biznesit - Aktivitet intensiv në para të gatshme

### Rasti 5

Një Raport i Transaksionit të Dyshimtë (RTD/SAR) ka fokusuar një person (Personi A) i cili njëkohësisht është pronarë i një biznesi (Kompania 2), i cili realizon transaksione financiare substanciale dhe intensive të cilat janë depozitime në para të gatshme në xhirollogarinë e biznesit, dhe të cilat realizohen para pagesave të cilat bëhen nga kjo xhirollogari.

Pas gjenerimit të rastit, NJIF-K, ka grumbulluar të dhëna financiare të cilat pasi futen në bazën e të dhënave, e njëjta ka gjeneruar skicën e mëposhtme:



**Grafikoni nr.5**

Disa nga dokumentet dhe të dhënat bankare evidencojnë personin e involvuar si të punësuar në një institucion privat. Këto qarkullime fillimisht nuk tërheqin vëmendjen për dyshim të mëtutjeshëm pasi bie në sy aktiviteti jo i madh financiarë në llogaritë e shumta individuale të personit të involvuar. Shumë nga xhirollogaritë bankare të personit në fjalë janë të fjetura (nuk kanë aktivitet financiarë fare).

Bazuar në të dhënat e institucioneve tjera të zbatimit të ligjit, Personi A është evidentuar për kërcënim dhe falsifikim dokumentesh, dhe ky fakt rritë edhe më tepër bazën për dyshim.

Personi A rezulton të jetë pronarë i dy bizneseve, njëri nga ta nuk ka fare aktivitet financiarë. Biznesi aktiv është krijuar disa vite më parë, dhe nuk është e qartë se nga vjen kapitali për të njëjtin, gjithashtu nuk ka kredi të cilat do janë shfrytëzuara nga personi për këtë qëllim.

NJIF-K ka krahasur të dhënat nga Autoritetet Tatimore me qarkullimin bankar, ku është vërejtur se kishte një diferencë të madhe në raport me aktivitetin financiarë të realizuar në xhironlogaritë e biznesit.

Aktiviteti financiarë në llogaritë individuale të personit të involvuar fillojnë në vitin 2009 si punëtorë në një institucion privat. Në vitin 2010 personi "A" figuron si pronarë biznesi, është fjala për biznesin aktiv i cili ishte themeluar më herët, ndërsa në vitin 2011 krijon edhe një biznes tjetër. Profili financiarë i tij deri më 2009, dhe ai pas 2010, ka ndryshim të madh dhe të pazakontë. Evidencohen numër i madh transaksionesh, ku bien në sy depozitimet (afërsisht €400,000 në tetë raste) dhe tërheqjeve në para të gatshme nga personi A.

Gjatë analizave të kryera në NJIF-K, është vërejtur se një biznes tjetër ishte duke transaksione të mëdha bankare me kompaninë e personit të përfshirë në këtë rast. Tipologjia e operimit financiarë nga biznesi i involvuar sugjeron se kemi të bëjmë me pagesa fiktive pa pasur aktivitet real ekonomik nga biznesi në fjalë në llogari të biznesit tjetër i cili është destinacion i transfereve të mëdha të përfshira në këtë rast.



## TRAFIKIM ME QENIE NJERËZORE


### Transfere të fondeve jashtë vendit të përfituara nga aktivitetet e paligjshme – trafikim me qenie njerëzore

#### Rasti 6

Një subjekt raportues ka raportuar një RTD (Raport të transaksionit të dyshimtë) se një person me shtetësi të huaj ishte duke transferuar fonde tek disa persona të ndryshëm pa ndonjë justifikim të qartë ekonomik. Transaksionet janë kryer në një periudhë prej rreth 9 muaj.

Pas verifikimeve të kryera për atë periudhë nuk ka rezultuar që personi në fjalë është e punësuar zyrtarisht në Kosovë, por pas një hetimi të kryer, rezultoi që i njëjti person punon ilegalisht në një restaurant në vendin tonë. Fondet e transferuara jashtë vendit kishin një diferencë të theksuar krahasuar me të ardhurat mujore që ai person ka mundur të arkëtonte duke punuar në një restaurant.

Nga konkludimet e dhëna dhe të nxjerra nga analizat financiare dhe pastaj të dërguara për hetim mëtutjeshëm në Agjensionet e Zbatimit të Ligjit, ka rezultuar që në kohën kur ishin duke u zhvilluar hetimet ai person hapi edhe një biznes në Kosovë kjo me qëllim të arsyetimit të dërgimit të fondeve jashtë vendit. Nga ai hetim rezultoi se personi në fjalë ishte duke menaxhuar dhe kontrolluar një numër të caktuar të disa femrave të ardhur nga disa vende tjera të njohura për trafikim me qenie njerëzore.



Grafikoni nr.6

## **Rasti 7**

Personi “F” i gjinisë femërore e lindur ne Shtetin “Z”, posedon dy nënshtetësi të dy shteteve të ndryshme. I njëjti person kishte paraqitur kërkesë për lejeqëndrim edhe në Kosovë. Si rezultat i analizave financiare dhe kërkimeve të kryera nga ana e NJIF-K është vërejtur se Personi “F” kryente edhe disa transaksione tjera me disa persona tjerë me shtetësi të huaj dhe dyshimi bazohet në faktin se këta persona kanë dërguar disa herë para nga Kosova në drejtim të dy vendeve Shteti “X” dhe Shteti “Y” në një periudhë të shkurtër kohore. Gjithashtu të njëjtit persona kishin pranuar fonde në Kosovë nga të njëjtat vende. Shumica e pranuesve të fondeve ishin persona që nuk kishin lidhje familjare me personat në fjalë. Për më tepër transaksionet kryheshin me shtetet e njohura si vende të trafikimit të qenieve njerëzore.


Në njërën nga llogaritë bankare në vendin tonë, personi në fjalë nuk kishte ndonjë qarkullim të madh bankarë, por ajo që bie në sy në atë llogari ishte fakti se përmes debit kartelës ishin bërë disa pagesa në shuma të vogla në disa dyqane në qytete të ndryshme bregdetare të vendeve të rajonit, gjë që tregon se personi në fjalë kishte lëvizur disa herë nga Kosova, dhe duke i shtuar kësaj edhe faktin se zonjusha “F” kishte kryer edhe disa depozita në kesh shumë vite më parë në llogarinë e saj bankare, atëherë lindin dyshime se ajo femër qe një kohë të gjatë ishte duke kryer aktivitete të paligjshme në Kosovë nën dyshimin e ushtrimit të prostitucionit.

Po ashtu, dyshimi tjetër vije nga një RTD tjetër i cili bazohet në faktin se njëra nga subjektet raportues duke monitoruar disa transaksione, kishte vërejtur se njëra nga personat e lartpërmendur Personi “F” me shtetësi të huaj, në llogarinë e saj personale kishte pranuar rroga mujore nga një firmë, restaurant kafe bar “H”. Po ashtu, është vërejtur se në njërën nga llogaritë bankare të subjektit “H” ishin kryer disa pagesa në emër të pagave mujore për disa persona të gjinisë femërore të cilat kishin kryesisht nënshtetësi të huaj të ardhura sidomos nga vendet e lindjes.

Bazuar në të gjeturat e cekura më lartë në këtë rast, dhe nga shënimet e siguruara nga ana e NJIF-K, është parë se personat e gjinisë femërore të ardhura nga vendet e lindjes kryesisht figurojnë si punëtores me profesion kameriere ose valltare. Shumat e deponuara nuk tregojnë se personat në fjalë mund t’i kenë përfitimet nga ato profesione, prandaj ne dyshojmë se shtetaset nga Shtetet “X” dhe “Y” janë përdorur për qëllime të prostitucionit.

Kompania e involvuar në këtë rast subjekti “H” si e dyshuar se qëndron pas gjitha aktiviteteve të atyre femrave, ishte themeluar disa vite më herët, dhe që nga themelimi thuajse nuk kishte kryer asnjë aktivitet ose të paktën nuk kishte deklaruar se ishte duke kryer aktivitet biznesor që do t’i gjeneronin të ardhura të ligjshme, ndërsa në anën tjetër paguan pagat për një numër të caktuar të të punësuarve. Përveç kësaj, disa nga ato femra gjatë hapjes së xhirollogarive kanë dhënë një adresë që ishte e ngjashme me adresën e biznesit të subjektit “H”, gjë që dyshojmë se objekti në të cilën ishte i vendosur lokali në fjalë ishte edhe objekt banimi, prandaj kjo e rrit edhe më tepër dyshimin se ato femra ishin duke ushtruar aktivitete të paligjshme gjegjësisht prostitucion.

Përveç subjektit “H”, NJIF-K dyshon se edhe një subjekt tjetër afarist “G” paguante në emër të pagave mujore disa nga ata persona, ku njëra nga personat në fjalë ishte arrestuar nga policia nën dyshimin e ushtrimit të prostitucionit, madje arrestimi ishte bërë pikërisht në lokalet e atij subjekti Coffe Bar “G”.



**Grafikoni nr.7**






## PASURIT E PALUAJTSHME

### Investimi i mjeteve në pasuri të patundshme


#### Rasti 8

NJIF-K ka pranuar një RTD në lidhje me një person i cili ka tërhequr para në te gatshme në shumë prej €70,000, të cilën shumë me pastaj e ka depozituar në një llogari personale të një shtetasi të huaj. Kjo shumë e parave pastaj është transferuar në një llogari bankare të një shteti tjetër.




Grafikoni nr.8.1

Vetëm disa ditë më vonë në NJIF-K ishte raportuar edhe një RTD/STR tjetër, dhe i cili kishte të bënte me një transaksion të kryer nga një person i cili vinte nga shteti i njëjtë dhe i cili ishte i lidhur me raportin e transaksionit të dyshimtë të paraqitur më lartë.



Grafikoni nr.8.2

Gjatë analizimit të transaksioneve nga grumbullimi i informacioneve, evidencohen transaksione tjera të dyshimta, ku njëri nga ato transaksione të dyshimta arrinte shumën mbi gjysmë milioni euro. Po ashtu, evidentoheh ndërlidhshmëri e personave dhe entiteteve të interfereuara nga këto transaksione. Evidentohet një numër i madh i bizneseve të krijuara të cilat operojnë në Kosovë me një aktivitet financiar substancial.



**Grafikoni nr.8.3**


Lëvizjet financiare me shtetin nga e kanë origjinën personat që nuk janë me origjinë nga Kosova janë të mëdha. Evidentohet fakti se transaksionet të cilat kanë shtyer në raportimin e RTD-ve kanë qenë vetëm fragmente të një aktiviteti të mëdh financiarë të personave vendor dhe ndërkombëtarë dhe kompanive të ndërlidhura. Kemi të bëjmë më 5 (pesë) persona vendor të involvuar në këtë rast dhe me disa persona të tjerë të huaj, të cilët ishin duke kryer transaksione të mëdha financiare ndërmjet tyre. Personi kyç i involvuar, ka edhe disa aktivitete tjera të cilat e profilizojnë atë si të dyshimtë për shkak të rënies së tij ndesh me ligjin në disa raste.

Gjithashtu kemi të bëjmë me dymbëdhjetë persona të ndërlidhur financiarisht të cilët operojnë me një numër të madh biznesesh në Kosovë.

Vërehet dukuria e krijimit të një numri të madh të bizneseve nga personi vendor dhe mandej blerja e tyre nga shtetasit e huaj. Krahasimi i qarkullimit bankar me të dhënat e raportuara ne autoritetet tatimore tregon një diferencë mjaft të madhe ndërmjet tyre. Kjo e ngrit dyshimin për përfshirjen në evazion fiskal të disa kompanive të cekura në këtë rast.

Rasti 9

Personi “X”, një qytetar në pension, ka blerë patundshmëri në vlerë prej 180,000 Euro. Shitës të atyre patundshmërive ishin pesë persona të ndryshëm. Fillimisht para se të transferoheshin ato mjete tek shitësit e patundshmërive, Personi “X” dhe tre persona tjerë deponuan mjete të konsiderueshme monetare në dy llogari të ndryshme bankare në dy banka komerciale në vend, Banën A dhe Bankën B. Personat në fjalë gjatë deponimit të mjeteve deklarorin se burimi i të ardhurave rrjedhë nga kursimet e viteve të kaluara. Por nga analizimi i transaksioneve është vërejtur se i njëjti person ishte person i autorizuar edhe në llogaritë bankare të nipit të tij (Personi Y) i cili ishte vetëm 10 vjeçar. Edhe pse llogaritë bankare të fëmijëve hapen me qëllim të kursimit të mjeteve, është vërejtur se kjo nuk është përdorur për qëllime të tilla. Në llogaritë bankare të Personit Y ishin kryer madje edhe deponime në kesh në vlera mbi 100,000 € dhe gjithashtu ishin kryer edhe transaksione tjera tepër të dyshimta në vlera të mëdha, kryesisht për shitblerje të patundshmërisë.




Grafikoni nr.9

## Rasti i 10

Personi “X” ka kryer blerjen e patundshmërive në vlerën prej 540,000.00€. Fillimisht ky person ka deponuar shuma të konsiderueshme të parave në llogaritë bankare dhe më pastaj i ka transferuar tek shitësit e patundshmërive.

Deponimet nga Personi X janë realizuar në para të gatshme (kesh), ku 22 deponime kanë qenë nën pragun e limitit të raportimit<sup>1</sup>, kryesisht shumat e deponuara në llogaritë bankare kanë qenë: (9,000.00€ - 9,900.00€). Me rastin e deponimit të mjeteve, personi X është pyetur për prejardhjen e mjeteve, ku ai person ka refuzuar të jap informata për burimin e parave dhe një veprim i tillë është cilësuar si i dyshimtë dhe është raportuar në NJIF-K.

Sipas informatave që NJIF-K ka mbledhur në lidhje me personin X, rezulton që i njëjti nuk ka kontratë pune në ndonjë institucion publik apo privat, si dhe nuk ka biznes të regjistruar në emrin e tij. Andaj, burimi i mjeteve financiare mbetet i dyshimtë për NJIF-K.



Grafikoni nr.10

<sup>1</sup> Neni 22, Ligji Nr.03/L-196: “Për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar, pragu apo limiti i raportimit është vlera prej 10,000 € ose më shumë.

## **KOMPANITË E SIGURIMEVE**

### **Lëvizje e mjeteve ndërmjet disa kompanive me të njëjtin pronar dhe integrim i atyre mjeteve përmes sigurimeve në të cilën kompani sigurimesh paraqitet i njëjti person**

#### **Rasti 11**

Është për tu habitur se si një kompani e cila ofron kurse të ndryshme kryesisht për gjuhë të huaj pranon fonde në vlerë mbi 280,000 € për një periudhë shumë të shkurtër kohore. Ky fakt ka zbuluar se shumica e atyre mjeteve të pranuar nuk kishin të bënin asgjë me aktivitetin e saj ekonomik por kryesisht ishin huazimet të rrjedhura nga transaksionet e kryera ndërmjet kompanive të lidhura me njëra tjetrën.

Tri kompani me adresë dhe emra shumë të ngjashëm (Kompania A, Kompania B dhe Kompania C) ishin themeluar në një periudhë të përafërt kohore dhe që të tria kishin pronar dhe bashkëpronar të ndryshëm, që rritë dyshimin se këto kompani janë fiktive, por ato janë të regjistruara me qëllim të komplikimit të hetimeve nga Agjensionet e Zbatimit të ligjit. Përveç se ishin themeluar kompani “fiktive” ato kryenin transaksione tepër të dyshimta me indikator të pastrimit të parave. Një kompani tjetër e cila ofronte shërbime të sigurimeve dhe e cila kishte bashkëpronar personin e njëjtë që qëndronte pas atyre tri kompanive tjera, kreu një transfer në vlerë prej 374,781.00 € tek Kompania A për pagesën e dëmit të pasurisë së siguruar. Të dy këto kompani kanë pronar të njëjtin person (Personi A). Vetëm disa ditë më vonë Personi A pranoi një shumë të madhe të mjeteve prej 410,000 € për rritjen e kapitalit fillestar në Kompaninë e Sigurimeve. Këto transfere rrisin dyshimin që Kompania e Sigurimit bëri një mashtrim duke paguar 374,781.00 € në emër të dëmit për Kompaninë A, kjo njëherit ndikoj edhe në rritjen e shpenzimeve duke pasur ndikim direkt në pasqyrën e të ardhurave përkatësish në fitimin para tatimit, ku me këtë rast në të njëjtën kohë e zvogëlon fitimin para tatimit duke i ikur edhe pagesës së tatimit në fitim. Kjo në fakt është një skemë e pastrimit të parave sepse vetëm një shumë pakëz më e madhe se sa pagesa e dëmit, ishte kthyer përsëri tek Kompania e Sigurimeve por nëpërmes kanaleve tjera rritjes së kapitalit aksionar në vlerën e cekur më parë (410,000 €) nga personi i njëjtë.

Përveç kësaj, fakti që Personi A ishte pronar i kompanisë e cila ishte e dyshuar për pastrim parash në një vend tjetër (bazuar në raportin e FIU së shtetit tjetër), dhe Personi B ishte i involvuar në disa aktivitete kriminale (Raporti i Policisë në vendin tonë), si dhe Personi C ka qenë i përfshirë në disa transaksione biznesore me disa vende të njohura si “Offshore Country”<sup>2</sup> tregojnë që këta individë kanë një të kaluar të tyre kriminale dhe dyshimi i lartë i përfshirjes së tyre në aktivitetin e pastrimit të parave.

---

<sup>2</sup> [http://www.imf.org/external/np/mae/oshore/2000/eng/back.htm#II\\_A](http://www.imf.org/external/np/mae/oshore/2000/eng/back.htm#II_A)  
[http://en.wikipedia.org/wiki/FATF\\_blacklist](http://en.wikipedia.org/wiki/FATF_blacklist)






## **PASTRIMI I PARAVE, KONTRABANDA DHE EVAZIONI FISKAL**

### **Rasti 12**

NJIF-K pranoj një informatë nga një subjekt raportues se dy persona që dyshohej se rrjedhin nga një familje, kryenin disa pagesa ndërkombëtare në drejtim të një vendi nga Lindja. Të dy personat nga llogaritë e tyre personale dhe bizneseve kishin arritur që në një periudhë shumë të shkurtër kohore të transferojnë jashtë vendit fonde në vlerë prej rreth 810,000 Euro dhe rreth 450,000 US Dollar. Thuajse gjitha ato mjete kishin shkuar tek disa kompani nga i njëjti vend, me përshkrimin pagesë për mall.

Të dhënat e agjensioneve të zbatimit të ligjit tregonin se të dy personat në fjalë ishin pronar të dy bizneseve të ndryshme, por që asnjëherë nuk kishin kryer në emër të atyre bizneseve ndonjë import ose eksport nga Kosova. Gjithashtu autoritetet tatimore kishin arritur të identifikonin mallrat që tregtoheshin në të dy kompanitë A dhe B, ku rezultatet tregonin se origjina e atyre mallrave ishte nga një shtet nga Lindja, përderisa pronarët e atyre kompanive kishin prezantuar disa fatura fiktive se gjoja mallin e blenin nga disa kompani vendore.

Fakti se transferet ndërkombëtare ishin kryer me qëllim të pagesës së mallit dhe duke analizuar aktivitetin e bizneseve të personave në fjalë, shitje e gjërave me pakicë, atëherë ishte dyshuar se të dy shtetasit kosovarë ishin duke kryer kontrabandë me mallra.




**Grafikoni nr.12**

## AGJENSIONET PËR TRANSFER PARASH DHE KËMBIMORET

### Rasti 13

Personi 'X' në një periudhë të shkurtër kohore konvertonte shumë shpesh para në njërin nga këmbimoret në vendin tonë. Gjatë analizimit të gjitha konvertimeve të realizuara në këmbimoren Y, ka rezultuar që personi në fjalë kishte konvertuar nga valuta USD në valutën Euro transaksione në vlerë totale prej rreth 455,000 USD dhe përveç kësaj edhe 397,000 Euro janë konvertuar në valuta tjera. Nga të dhënat shtesë të mbledhura nga ana e NJIF-K, rezultojë se Personi X në të njëjtën kohë ishte duke përdorur edhe llogaritë bankare për konvertim të parave dhe gjithashtu ky person kishte kryer disa depozita në kesh në vlera të mëdha. Në njërin nga ato llogari bankare është vërejtur se personi në fjalë ka pranuar dhe dërguar disa transfere nga apo tek e njëjta zyre këmbimore ku edhe kryente konvertime e mjeteve valutore. Vlera e transfereve hyrëse tregonte një shumë në total prej rreth 320,000 Euro, ndërsa mjetet e transferuara nga Personi X tek këmbimorja Y kapnin vlerën në një total prej 295,000 Euro dhe 270,000 USD.

Të dhënat e agjensioneve të zbatimit të ligjit tregojnë se personi X, nuk kishte asnjë biznes të regjistruar në emrin e tij dhe as nuk ishte i punësuar në atë periudhë kohore kur kryente transaksione. Kryerja e konvertimeve të atilla, depozitimeve në kesh pa ndonjë justifikim të qartë ekonomikë si dhe transferet e kryera ndërmjet Personit X dhe Zyrës Këmbimore Y, ishin fakte të arsyeshme për përcjelljen e rastit tek agjensionet e tjera të zbatimit të ligjit për hetime të mëtutjeshme.




Grafikoni nr.13

## FINANCIMI I TERRORIZMIT

## Rasti 14

Një OJQ me seli në vendin tonë, pranonte vazhdimisht fonde nga një organizatë tjetër nga Lindja e Mesme. Fillimisht subjekti raportues dyshonte se transferet hyrëse ndërkombëtare vinin nga një organizatë e cila e kishte selinë e saj në një nga vendet e Lindjes së Mesme dhe e cila dyshohej se gjendet në listën e OKB-së dhe e cila është dyshuar të ketë lidhje me Al Qaiden dhe Talibanët.

Por gjatë analizave të kryera nga ana e NJIF-K dhe pas kërkimeve të kryer në burime të hapura, është vërejtur se organizata e cila dërgonte fonde në Kosovë ishte e ndryshme nga ajo e cila ishte në Listën e organizatave për financim të terrorizmit, por që kishin emra përafërsisht të ngjashëm, dhe se OJQ-ja tjetër e cila ishte në atë listë e kishte selinë nga një vend i BE-së. Gjithashtu themeluesit e të dy OJQ-ve ishin persona të ndryshëm. Mirëpo duke analizuar transaksionet bankare të organizatës jo qeveritare me seli në Kosovë është vërejtur se ishin kryer disa transaksione të dyshimta, sidomos tërheqjet në kesh, dhe kishte disa lidhje me disa organizata dhe kompani tjera në Kosovë. Ky element ka bërë që NJIF të ngrit dyshimet nëse lidhjet ndërmjet atyre subjekteve kishin të bënin me aktivitet komercial apo me aktivitete tjera të paligjshme. Andaj bazuar në këto të dhëna NJIF kishte shpërndarë një raport tek agjensionet tjera të zbatimit të ligjit për hetimin e lidhjeve ndërmjet atyre personave dhe subjekteve.



Grafikoni nr.14

## **LOJRAT E FATIT DHE KAZINOT**

### **Rasti 15**

NJIF-K pranoi një informatë në lidhje me një person “T” rezident i Kosovës, i cili ishte duke kryer disa transaksione të njëpasnjëshme depozita në kesh, shumica e tyre nën pragun e raportimit, duke ndryshuar vazhdimisht degët e bankës. Ato mjete deponoheshin në llogarit e një subjekti – shtëpi e lojërave të fatit “K”. Gjatë analizave të kryera nga ana e NJIF është zbuluar se Subjekti “K” më parë kishte ndryshuar emrin e kompanisë, ku ishte vërejtur se fillimisht themelues i atij subjekti ishte një kompani LTD e cila kishte origjinën nga një vend i njohur si Offshore<sup>3</sup>.


Nga analizat e kryera rezultojë gjithashtu se përveç Personit “T” ishin edhe katër persona tjerë të cilët kryenin transaksione të shpeshta dhe nën pragun e raportimit dhe të cilët përveç llogarive të Shtëpisë së Lojërave të Fatit “K”, ata përdornin edhe llogarit e tyre personale për kryerjen e transaksioneve në emër të atij subjekti. Disa nga ata persona ishin edhe shtetas të disa vendeve të BE-së. Të gjithë personat e përfshirë në këtë rast në një periudhë të shkurtër kohore kanë depozituar mjete në kesh (rreth 280,000 Euro) në të njëjtat data, në të njëjtat shuma dhe kanë përdorur të njëjtat degë të bankës për kryerjen transaksioneve për subjektin “K”. Gjithashtu nga të njëjtë persona në një periudhë tjetër kohore thuajse në të njëjtën mënyrë janë kryer transaksione në depozita në kesh në vlerë totale mbi 500,000 Euro.

Duke analizuar aktivitetin financiarë të Subjektit “K” është vërejtur se ky subjekt pranonte mjete monetare pa ndonjë justifikim të qartë ekonomikë nga disa persona tjerë të panjohur të cilët kishin arritur t’i bartin tek llogaria e biznesit të subjektit në fjalë një shumë totale prej rreth 280,000 Euro. Por ajo çfarë në realitet ishte tepër e dyshimtë, ishte fakti se të pesë personat e dyshuar në këtë rast, kishin arritur t’i transferonin në një vend të Evropës mbi 1.5 milion euro, prej nga pastaj ato mjete barteshin tek disa kompani që kishin lidhje me vendet Offshore.

Profili i të kaluarës kriminale të pesë personave tregonte se katër nga ata kishin kryer vepra penale në Kosovë duke u përfshi edhe në trafikim të narkotikëve.

---


<sup>3</sup> [http://www.imf.org/external/np/mae/oshore/2000/eng/back.htm#II\\_A](http://www.imf.org/external/np/mae/oshore/2000/eng/back.htm#II_A)  
[http://en.wikipedia.org/wiki/FATF\\_blacklist](http://en.wikipedia.org/wiki/FATF_blacklist)



Grafikoni nr.15

Rasti i 16

Personi “Y” shtetas i një vend të BE-së dhe me prejardhje nga një vend i lindjes së afërt kreu transferimin e një shume të konsiderueshme të mjeteve në vlerë mbi gjysmë milioni euro për në Shtetin “Q” i njohur si vend i parajsës fiskale apo Offshore. Atë transfer ndërkombëtar personi në fjalë e kreu “për çështje biznesi”. Por gjatë kryerjes së hetimeve është identifikuar që paraprakisht një shumë prej €700,000.00 ishte transferuar nga Shteti “S” në një bankë komerciale në Kosovë. Në ndërkohë, ishte tërhequr nga kjo shumë, në të gatshme vlera prej €100,000. Pas grumbullimit informatave lidhur me personin në fjalë, kuptohet se personi ishte në proces të hapjes së një Kazinoje në Kosovë dhe se i njëjti kishte hyrë në Kosovë me tri pasaporta të ndryshme. NJIF-K lëshon urdhër administrativ për ngrirjen e llogarisë bankare dhe rasti referohet për hetime të mëtutjeshme tek institucionet e zbatimit të ligjit të cilat po ashtu e vazhdojnë edhe për një periudhë të caktuar ngrirjen e kësaj llogarie bankare. Personi “Y” e kishte lëshuar Kosovën për një kohë të gjatë dhe shuma prej €70,000 që kishte mbetur në llogarin bankare, e afatizuar për një periudhë rreth 5 vite, transferohet në një vend të BE-së, dhe menjëherë pas kësaj NJIF-K e njofton FIU-n e këtij vendi me raport të veçantë.



Grafikoni nr.16




## PASTRIMI I PARAVE I BAZUAR NË TREGTI

### Rasti 17

Duke u bazuar nga të dhënat e marra nga një obligues ligjor, NJIF-K filloj analizimin e rastit dhe rezultatet tregonin që një person 'X' me shtetësi të Kosovës, brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore (rreth 1 vit) pranonte në mënyrë të vazhdueshme fonde, të transferuara nga një shtet tjetër dhe të urdhëruara nga një kompani 'S' e atij shteti por që kishte përfaqësinë edhe në vendin tonë, ndërkohë që personi në fjalë nuk kishte asnjë lidhje ligjore me përfaqësinë apo subjektin në fjalë. Vlera totale e mjeteve të pranuar nga Personi 'X' arrinte shumën rreth 390,000 Euro. Të gjitha ato mjete ishin bartur përmes 38 transfereve, ku rreth 90 % ose 35 nga 38 transferet ndërkombëtare ishin kryer nën pragun e raportimit (€ 10,000). Ato fonde në të njëjtën periudhë kohore janë tërhequr pastaj në kesh. Gjithashtu gjatë analizave rezultoi se personi i cekur më lartë nuk ishte i punësuar dhe se nuk kishte asnjë biznes të regjistruar në emrin e tij.

Nga analizimi i të dhënave bankare rezultoi që personi i dyshuar në këtë rast, figuronte edhe si person i autorizuar në llogarinë bankare të një biznesi privat 'G' shpk, e cila kompani në atë periudhë kohore transferonte mjete monetare pa ndonjë justifikim të qartë ekonomikë përveç shtetit nga fillimisht vinin fondet edhe në dy shtete të ndryshme. Disa vite më herët Personi 'X' ishte pronar i asaj kompanie. Dyshohet se burimi i këtyre fondeve të transferuara në ato dy shtete rrjedhë nga kompania 'S' e cila edhe pse e kishte përfaqësinë e saj në Kosovë, mjetet nuk i bartte përmes saj por përmes personave fizik dhe kompanive të lidhura me atë person.



Grafikoni nr.17

## **Rasti i 18**

Një shtetase ‘Y’ e një vendi nga Bashkimi Evropian (BE) kishte kryer një transfer të mjeteve në vlerë prej 635,000 Euro. Transferimi i mjeteve monetare ishte urdhëruar të kryhet nga një bankë e shtetit të BE-së dhe llogaria përfituese ishte llogaria personale e personit në fjalë në njërin nga bankat komerciale në Kosovë. Gjatë hapjes së llogarisë personi ‘Y’ ishte e shoqëruar nga Personi ‘Z’ shtetas i Kosovës, i cili ishte edhe person i autorizuar të ketë qasje në atë llogari bankare. Nuk ishte e qartë për bankën se çfarë lidhje apo bashkëpunimi mund të jetë ndërmjet atyre dy personave. Shtetasi ‘Z’, disa ditë më vonë, kishte shkuar në njërin nga degët e bankës ku qëndronin fondet dhe kishte kërkuar të tërhiqen në kesh një shumë e konsiderueshme e mjeteve në vlerë prej 260,000 Euro brenda një transaksioni të vetëm. Meqë nëndegja e bankës kishte limit të caktuar të mbajtjes së kesh-it, personit ‘Z’ i është pamundësuar një tërheqje e tillë e mjeteve në të gatshme. Personi në fjalë vetëm disa ditë më vonë kishte tërhequr në kesh nëntë transaksione të gjitha në vlera totale prej 29,500 Euro. Gjithashtu personi ”Z” edhe më parë kishte pranuar disa shuma të parave të transferuara nga Personi “Y”, ku vlera më e lartë e tyre ishte deri në 40,000 €.

Gjatë procesit të analizimit të rastit, NJIF-K kishte bërë një kërkesë për informata tek Njësia homologe e saj (FIU e jashtme) dhe përgjigja e tyre ishte se personi ‘Z’ ishte i njohur për autoritetet e shtetit nga janë transferuar fondet. Disa vite më parë ky person kishte qëndruar në atë shtet dhe ishte dënua me disa vite burgim për trafikim me droga (diler i heroinës). Një fletë-arrest ndërkombëtar ishte lëshuar për personin në fjalë.

Në atë periudhë kohore NJIF-K kishte urdhëruar ngrirjen e llogarisë bankare për 48 orë të personave të cekur në këtë rast, dhe pastaj me urdhër të prokurorit ngrirja e llogarisë kishte vazhduar edhe për një periudhë të caktuar kohore.

Gjatë periudhës hetimore nga Institucionet e zbatimit të ligjit në vendin tonë, por edhe hetimet e rifilluara në shtetin e origjinës së fondeve (të cilat kishin filluar pas njoftimit nga ana e NJIF Kosova dhe me qëllim të zbulimit të prejardhjes së fondeve), Personi ‘Z’ gjatë intervistave kishte deklaruar:

- Bartja e fondeve (635,000 €) nga personi “Y” ishte bërë për qëllime biznesi, dhe se ai kishte lidhje biznesore me Personin ‘Y’ për rreth dy vite më parë.
- Qëllimi i ardhjes së fondeve në Kosovë ishte ndërtimi i një fabrike, pa dhënë detaje se çfarë do të prodhohet në atë fabrikë.

Në kohën kur ishte kryer transferi i mjeteve (635,000 €), Personi ‘Z’ kishte marrë pjesë në procesin e privatizimit të një ndërmarrje në Kosovë, por që nuk kishte arritur të fitonte. Njëra nga pistat e dyshimit ishte edhe se ato mjete me prejardhje të dyshimtë kanë pasur për qëllim të përdorën për privatizime.


- Kur ishte pyetur personi ‘Z’ se çfarë eksperience ka në atë biznes, ai deklaroi kishte poseduar një kompani ndërtimi në një vend të BE-së ( i ndryshëm nga vendi rezident i

personit 'Y'). Në pyetjen se si quhej emri i kompanisë në shtetin e BE-së, ai tha se emri i atij biznesi ishte i ngjashëm me emrin dhe mbiemrin e tij. Gjithashtu ai deklaroi se ajo kompani nuk kishte asnjë person të punësuar në atë ndërmarrje,

- Në pyetjen se të kujt ishin ato mjete (635,000 Euro) të transferuar në vendin tonë, ai deklaroi se shumica ishin të zonjushës 'Y', por një pjesë rrjedhin edhe nga biznesi i tij i ushtruar në shtetin e BE-së,
- Gjithashtu kur ishte pyetur se për çfarë arsye i kishte transferuar 40,000 Euro zonja/zonjusha 'Y' disa kohë më parë, Personi 'Z' deklaroi se ato mjete i kishte pranuar si dhuratë dhe me qëllim të kryerjes së shpenzimeve ditore/mujore. Po ashtu ai pranonte edhe dhurata tjera nga Personi 'Y' duke përfshi një automjet luksoz, parfume, stoli të çmuara etj.
- Pjesën më të madhe të atyre mjeteve ai deklaroi se i shpenzonte në hotele dhe kazino dhe jo në biznes. Gjithashtu edhe tërheqjen e mjeteve nga llogaria në vlerë prej 29,500 €, ai e justifikoi duke deklaruar se i ka shpenzuar në lojëra të fatit, dhe tha se të gjitha i kishte humbur. Po ashtu, ai tha se ato mjete i kishte shpenzuar në disa Kazino dhe shtëpi të lojërave të fatit në dy shtete fqinjë në Ballkan.
- Personi 'Z' deklaroi se dëshironte të tërhiqte atë shumë të konsiderueshme të mjeteve nga llogaria (260,000 €), për t'i bartur në një bankë tjetër me qëllim të shmangies së pagesës së shpenzimeve të mirëmbajtjes së llogarisë. Por që në realitet mirëmbajtja e llogarisë ishte e njëjtë në të dy bankat (1 Euro).
- Ai pohoi gjithashtu se ishte takuar me zonjën/zonjushën 'Y' disa javë më herët në Kosovë ku kishin diskutuar edhe rreth ngrirjes së llogarisë dhe bllokimit të mjeteve monetare. Kur ishte pyetur se çfarë profesioni bën Personi 'Y', ai deklaroi se ajo ka një biznes në një shtet tjetër të BE të cilin e kontrollon së bashku më vëllanë e saj.
- Ata gjithashtu gjatë asaj periudhe kishin shkuar edhe në pushime në një vend bregdetar shumë luksoz, duke shpenzuar një shumë të konsiderueshme parash. Personi 'Z' deklaroi gjithashtu se me zonjën/zonjushën 'Y' kanë lidhje shoqërore dhe shkojnë shumë shpesh në pushime së bashku.

Është për tu besuar fakti se personi 'Z' kurrë nuk investoi në Kosovë dhe nuk ndërtojë asgjë në emrin e tij, andaj dyshohet se parat e transferuara nga personi 'Y' (dyshohet e dashura e tij) mund të jenë bërë me qëllim të blerjes dhe trafikimit të narkotikëve, për të cilën gjë shtetasi 'Z' veç ishte familjarizuar.

## PASTRIMI I PARAVE I BAZUAR NË TREGTI




Grafikoni nr.18



**Rasti i 19**

Një person në moshë të re, ishte raportuar nga një subjekt raportues se ai ishte duke bërë depozitime të mjeteve në valuta të huaja. Vetëm në dy raste personi i njëjtë kishte arritur t'i deponoj në një nga bankat lokale dy shuma të mëdha të mjeteve CHF100,000 dhe CHF70,000. Të dy këto shuma pastaj transferohen në një bankë tjetër lokale në vendin tonë. Personi është evidentuar si pronar i një biznesi hotelier dhe një tjetri i cili merret me shitje të derivateve të naftës. Personi në fjalë gjithashtu evidentohet me përdorim të një numri të madh të llogarive bankare (11 sosh) si individuale ashtu edhe llogari të biznesit, në disa banka lokale. Disa nga llogaritë tjera bankare të personit të involvuar nuk kanë ndonjë aktivitet të theksuar financiar. Personi po ashtu deklaroi se është duke punuar në një shtet të Evropës, por aktiviteti i tij financiar nuk e konfirmon një gjë të tillë, sepse shumicën e kohës ky person jeton në Kosovë. Bizneset e tij vendore nuk kanë realizuar ndonjë deklaram tatimor, ashtu sikurse as origjina e fondeve të tij nuk është dëshmuar se rrjedh nga aktivitetet biznesore të personit në fjalë. Paratë e depozituara në llogarinë e tij të biznesit investohen në prona të paluajtshme. Rasti në fjalë është dërguar tek institucionet tjera të zbatimit të ligjit për hetime të mëtutjeshme.



**Grafikoni nr.19**